

PERISKOPI



Klubi për
Politikë të
Jashtme

Guardian Blutspuren im gelben Haus—Der Spiegel Monster or Savior
Doctor Draws New Scrutiny—The New York Times Marty's report lacks
the details—The Times EU probes organ trafficking allegations in
Kosovo—The Washington Post A bad week—The Economist Kosovo's
gefährlichster Mann mit Schweizer Vergangenheit—Neue Züricher
Zeitung La rumeur de Burrel—Le Monde Kosovo's PM linked to trade
in human organs—The Independent Il capo del governo del Kosovo
guidava il traffico di organi—Corriere della Sera Report identifies
Hashim Thaci as 'big fish' in organised crime—The Guardian Blutspuren
im gelben Haus—**OSE QEVERI TË** or? Doctor Draws New
Scrutiny—The N **KORRUPTUAR OSE** ks the details—
The Times EU p Kosovo—The
Washington Post **INVESTIME TË HUAJA** efährlichste
Mann mit Schweizer Vergangenheit—Neue Züricher Zeitung La
rumeur de Burrel—Le Monde Kosovo's PM linked to trade in human
organs—The Independent Il capo del governo del Kosovo guidava

Report identifies Hashim Thaci
Guardian Blutspuren im gelben
Doctor Draws New Scrutiny—Th
the details—The Times EU pro
Kosovo—The Washington Post
gefährlichster Mann mit Schwe
Zeitung La rumeur de Burrel—L
in human organs—The Indeper
guidava il traffico di organi—C
Hashim Thaci as 'big fish' in orga

Hyrje

Gjatë tre viteve të fundit të Kosovës si shtet të pavarur, raporte të njëpasnjëshme, qoftë vendore apo ndërkombëtare, kanë tërhequr vëmendjen se përmasat e korrupsionit po dëmtojnë zhvillimin e vendit po aq sa edhe imazhin e Kosovës në skenën ndërkombëtare. Viti 2010 filloi me raporte për nivele eklatente të korrupsionit dhe krimit të organizuar në qarqet më të larta të udhëheqësive së vendit. Fundviti ishte edhe më i furishëm. Ajo që filloi me raportin e publikuar nga Raportuesi i Këshillit të Evropës Dick Marty rezultoi në qindra artikuj në mediat më prestigjioze evropiane që flasin për inkriminimin e politikës kosovare. Për t'i vënë kapakun, zgjedhjet e para demokratike degraduan në masën që diplomatë perëndimorë e vlerësuan si "vjedhje industriale të votës".

Mungesa e vullnetit politik për të vendosur rend dhe ligj janë duke e dëmtuar në kontinuitet Kosovën, duke ulur gjasat e saj për të qenë mjedis atraktiv në tërheqjen e investitorëve të huaj. Shqetësimet më të mëdha janë rreth punës së sektorit publik, gjyqësorit dhe zbatimit të ligjit, përderisa numri i dënimeve përfundimtare në raste të korrupsionit mbetet i vogël.¹ Raporti i progresit i Komisionit Evropian- një vit më parë kishte shokuar publikun me informatën se 168 milionë euro të buxhetit të konsoliduar ishin shpenzuar përmes prokurimit njëburimor.

Në konferencën e titulluar "Si po e largon korrupsioni investitorin e huaj", të organizuar në dhjetor 2009, Klubi për Politikë të Jashtme kishte tërhequr vërejtjen për dëmet që po i shkaktohen procesit të tërheqjes së investimeve të huaja nga prania e lartë e korrupsionit politik në vend. Në atë raport kërkoheshin masa urgjente për luftimin e korrupsionit. Raporti kishte vënë dyshime në mënyrën e menaxhimit të parasë publike në Ministrinë e Transportit, procesin e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe privatizimit të ndërmarrjeve publike të "Llankosit" e "Feronikelit".

Ndërkohë, që nga viti 2007, shumica e investimeve të huaja në Kosovë ka shënuar rënie. Sipas raportit të progresit investimeve të huaja neto në Kosovë kanë rënë prej 19% në 7.1% të GDP-së.

Bastisjet në MTPT-në

Në pranverë të vitit 2010, opinioni publik në Kosovë është tronditur nga zbulimi se zyrtarë të lartë të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit janë nën hetime për vepra të rënda penale. Më 29 prill 2010, Policia e EULEX-it kishte kryer bastisje në MTPT-së, në prona private të zyrtarëve të lartë të kësaj ministrie dhe në disa kompani. Janë bastisur zyra e ministrit dhe shefit të prokurimit si dhe prona e vëllait të ministrit; pastaj janë bërë bastisje në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës ku janë të vendosur serverët si dhe në një zyrë në Komunën e Gjilanit.

"Dy të pandehurit, ministri dhe shefi i prokurimit, akuzohen për shpëlarje parash, krim të organizuar, shpërdorim të detyrës, mashtrim në detyrë dhe nxitje të rryshfetit", ka thënë Zëdhënësi i EULEX-it Blerim Krasniqi² duke njoftuar se për çfarë dyshohen këta zyrtarë.

Të pandehurve u është shtuar edhe zyrtari i Departamentit të Teknologjisë Informative në MTPT-së, Gani Zogaj, i cili ishte arrestuar më 29 korrik, si rezultat i zhvillimeve të hetimeve bërë ndërkohë. I pandehuri akuzohet për pengim në mbledhje të provave.

Në raportin e KPJ-së të publikuar në vitin 2009 u shprehë dyshimi se rritja enorme e investimeve kapitale brenda MTPT mund të jetë e motivuar edhe për përfitime të jashtëligjshme të udhëheqësve të saj. Shtatëfishimi i buxhetit të investimeve publike nuk mund të shihej si një dukuri normale brenda një konteksti të stagnimit të përgjithshëm ekonomik të vendit.

Edhe përkundër kërkesave të shumta të shoqërisë civile, pranisë ndërkombëtare në Kosovë dhe forcave politike opozitare, as Ministri Limaj e as shefi i prokurimit të kësaj ministrie



Kryeredaktor:
Ylli Hoxha

Redaktore:
Besa Luci

Hulumtues:
Besa Luci
Driton Sylja
Ardian Arifaj
Arban Mehmeti

Fotografite:
GETTYIMAGES
KOHA NET

Dizajni:
Trembelat

Kontakti
office@foreign-
policyclub.org
+ 381 38 221 881

PËRKRAHUR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Embassy of Switzerland in the Republic of Kosovo

1 Raporti i Progresit 2010 i Komisionit Evropian

2 Komunikim me emejll mes KPJ dhe Zyrës për Informim të EULEX-it, 13 shtator 2010.

Çështja e mospagesës së 16 milionë eurove është ngritur në Kuvendin e Kosovës nga deputetët Driton Tali dhe Naim Rustemi të cilët kanë kërkuar shpjegime

nuk u larguan nga detyra. Për më tepër, dy projekte madhore ekonomike të Kosovës: dhënia me koncesion e Aeroportit të Prishtinës dhe kontraktimi i ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdare u realizuar nën udhëheqjen e tyre pas bastisjeve.

Licencimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile

Tregu i telefonisë mobile në Kosovë ka qenë pikëtakim për shumë kompani të telefonisë me renome botërore që nga viti 2004. Megjithatë, shumë prej tyre u përballën me zhgënjime para hyrjes në garën e përzgjedhjes për licencim të operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë. Ky tender i përsëritur dy herë paraqiste një proces të ndërlikuar me shumë parregullsi. Ky sektor gjithashtu mund të konsiderohet si një nga pikat që komprometojnë imazhin e Kosovës dhe relacionin e saj me investues të huaj. Përkundër interesimit të treguar nga kompani me renome botërore, siç janë Vodaphone, Telenor, Mobilkom Austria – të gjitha me qindra milionë klientë anembanë botës – Autoriteti Rregullator për Telekomunikacion i Kosovës, ART, udhëhoqi një proces i cili rezultoi me licencimin e një ofertuesi anonim që nuk kishte klientë në industrinë e telefonisë mobile.

Raundi i dytë i tenderit për licensimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile ishte përsëritur në 2006/2007. Tenderi i përsëritur kishte joshur kompani serioze si “Telenor”, “France Telecom”, “Matav”, “Vodafone” e “Tele 2”. Ndërsa, ofertuesit më ngulmues në tender ishin “Mobilkom Austria”, konsorciumi “IpkoNet-Telecom Slovenia Mobitel”, “Team Kosovo” dhe konsorciumi “Kosmocell”.

Që në fillim të hapjes së tenderit, ofertuesit ende pa u futur mirë në proces u zhgënjyen për shkak të parregullsive të procesit. Si pasojë e kësaj u tërhoq në formë demonstrative nga gara kompania Vodafone.

“Njëra nga shkeljet që i ka bërë ART-ja në këtë rast është se nuk i ka publikuar kriteret se

çfarë kërkohet nga një ofertues në mënyrë që t’ua mundësoj atyre të përgatiten”, shprehet Avni Zogiani, drejtor ekzekutiv në organizatën joqeveritare Çohu.

Shkelje tjetër në këtë tender ishte përzgjedhja e fituesit në mungesë të një anëtarit të bordit, gjë që është në mospajtim me ligjin e telekomunikacionit që kërkon që për marrjen e vendimeve duhet të jetë i pranishëm i tërë bordi.

“Unë nuk e di si ia kanë dhënë Kosmocellit tenderin kur atëherë as bordi nuk ka qenë i kompletuar”, tha deputeti i pavarur në përbërjen e kaluar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Driton Tali.

Lista e shkeljeve të ligjit në këtë proces është bukur e gjatë, thuhet në raport. Përkundër këtyre parregullsive në tenderim, ART kishte shpallur fitues konsorciumin “Kosmoscell”.

Por, telasht nuk përfunduan me kaq. Konsorciumi fitues nuk kishte arritur të sigurojë mjetet e deklaruar për investim që kapnin shumë prej 81 milion euro, sa pat premtuar të investojë. Prandaj, pas skadimit të afatit për pagesë, licenca i është dhënë ofertuesit të dytë më të mirë “IpkoNet-Telecom” që kishte realizuar pagesën, sipas rregullave, si ofertuesi i dytë më i lartë. Në anën tjetër, garancia bankare që kapte shumën e 20 % të investimit të përgjithshëm që ishte dokument i domosdoshëm për secilin garues, e depozoi në ART nga konsorciumi Kosmocell doli të mos jetë valide. Kosmocell asnjëherë nuk pagoi shumën prej 16 milionë euro buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Çështja e mospagesës së 16 milionë eurove është ngritur në Kuvendin e Kosovës nga deputetët Driton Tali dhe Naim Rustemi të cilët kanë kërkuar shpjegime. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, duke i u përgjigjur deputetëve kishte drejtuar gishtin kah ART-ja. Ndërsa kryesuesi i bordit të ART-së, Ekrem Hoxha, kishte deklaruar se “për Bordin çështja e garancisë ka qenë temë e panjohur deri kur është shtruar pyetja në Kuvend” përkundër faktit se Legjislatura e kaluar e Kuvendit e kishte diskutuar procesin





në një mbledhje të jashtëzakonshme. “Më pas kemi filluar investigimet dhe në arkiv është gjetur garancia”, qe shprehur Hoxha .

Periskopi meson se kjo çështje tash është nën hetime të EULEX-it. “Unë i kam ofruar EULEX-it dokumente për të hetuar më thellë dhe mund të them se EULEX-i është duke hetuar”, i ka thënë Ekrem Hoxha KPJ-së në një intervistë me telefon³. “Unë nuk mund të them më tepër, ajo çfarë kam thënë unë është se ajo është vetëm një garanci bankare dhe nuk është një çek”.

Për Avni Zogianin tenderi i operatorit të dytë mobil ka qenë “zemra e krimit të organizuar” që

ka zbuluar sa thellë shkon krimi dhe korrupsioni në Kosovë. Ndërsa për deputetin Driton Tali ka qenë “shkelje me dy këmbë e ligjit të prokurimit dhe procedurave të tjera ligjore”.

Përkundër hetimeve të nisura nga EULEX-i dhe dyshimeve të shumta të ngritura nga mediat deri sot, asnjë zyrtar i ART-së i përfshirë në këtë proces nuk është gjetur përgjegjës apo shkarkuar nga posti. Madje ndonjëri prej tyre edhe është avancuar. Kreu i ART-së, Anton Berishaj disa muaj më vonë ishte emëruar si Ambasador i Republikës së Kosovës në Slloveni.

³ Më 6.07.2010







Shitjet e rradhës

Këto janë vetëm dy nga shumë rastet që muajt e fundit janë ngritur në pah nga shoqëria civile, mediat apo deputetë të Kuvendit të Kosovës. Të gjitha tregojnë për shkallën e patolerueshme të infiltrimit të krimit në vendimmarrje. Në këto shkelje, siç thonë bashkëbiseduesit e KPJ-së, janë të përfshira më shumë qarqe institucionale se sa mendohet në shikim të parë.

Shitja e aseteve me interes kombëtar për të mbyllur deficitin buxhetor mund të jetë zgjidhje pragmatike e krizës, por alarmon për mungesë elementare të përgjegjësisë dhe vizionit ekonomik të lidershit aktual

Por kultura e pandëshkueshmërisë e instaluar që nga viti 1999, ka filluar t'i prodhojë reperkusionet e veta të para. Media prestigjioze evropiane që nga përfundimi i zgjedhjeve nacionale kanë shënjestruar Kosovën dhe çdo ditë e më shumë po e portretojnë atë si fole të krimit.

Në tetor të vitit të kaluar organizata ndërkombëtare Transparency Internacional alarmoi për prani të lartë të korrupsionit politik në vend. Sipas TI Kosova është shteti më i korruptuar në rajon dhe mbanë pozitën e 110 krahas Beninit, Bolivisë e Gabonit. Në anën tjetër, Banka Botërore e rendit Kosovën në vendin e 173 për mbrojtjen e investitorëve.

Me një imazh të tillë Kosova, e ka të pamundur ta çojë më tutje projektin e saj shtetformues, e brenda tij, e ka të pamundur zhvillimin ekonomik, ku investimet e huaja direkte kanë një rol të patejkalueshëm. Dhjetë vitet e fundit me dhjetra kompani serioze kanë ikur të zhgënjyer nga Kosova, ndërsa në Kosovë ka mungesë të ndonjë kompanie me prestigj ndërkombëtar. Për t'u ndryshuar ky trend duhet filuar me punë sistematike në krijimin e ambientit miqësor ndaj biznesit, ku një prej parakushteve mbetet luftimi i korrupsionit dhe vendosja e shtetit ligjor.

Në muajt që vijnë Qeveria e Kosovës pritet të fillojë tri procese të rëndësishme ekonomike që mund ta determinojnë kahjen përfundimtare të Kosovës, kah dështimi apo ngritja graduale ekonomike. Koncesionimi i resurseve energjetike (së bashku me privatizimin e KEK-ut), privatizimi i PTK-së dhe privatizimi i kompleksit turistik Brezovica janë tri projektet të rëndësishme vitale për ekonominë e Kosovës.

Mirëpo, fundi i vitit 2010 ka treguar tendencë për të shpërdorur edhe këto resurse, në radhë të parë për ta mbuluar deficitin buxhetor të krijuara me vendimin për investimet e mëdha infrastrukturore. Filimi i vitit ka shënuar thellim të këtij hendekut financiar me vendimet për ngritje pagash të marra në ekzistencë elektorale të kryeministrit në dorëheqje.

Këto projekte mund të shfrytëzohen për krijimin e partneriteteve strategjike me investitorë serioz ndërkombëtar që do t'i kontribuonin krijimit të një klime të favorshme për nxitjen e investimeve tjera. Shitja e tyre për të mbyllur deficitin buxhetor mund të jetë zgjidhje pragmatike e krizës, por alarmon për mungesë elementare të përgjegjësisë dhe vizionit ekonomik të lidershit aktual.

Raportet e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar

Imazhi i Kosovës është prekur shumë në këta muajt e fundit nga raportet në mediat ndërkombëtare që flasin për lidhjet mes lidershit politik të vendit dhe krimin të organizuar. Në një ambient të tillë, Kosova duhet të dëshmojë se është partner i besueshëm dhe serioz në marrëdhëniet me partnerët e jashtëm.

Pasqyrë e kësaj janë marrëveshjet që Kosova tanimë ka nënshkruar me organizata ndërkombëtare në të cilat ka arritur të anëtarësohet, me theks të veçantë në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Kosova është bërë anëtare e FMN-së në qershor të vitit 2009 kryesisht falë faktit që vendet që e kanë mbështetur Kosovën janë vende më me ndikim në këtë organizatë të rëndësishme financiare globale. Në korrik 2010, FMN ka miratuar kërkesën e Qeverisë së Kosovës për një Stand-by Arrangement⁴ me të cilin Kosovës i jepen 92, 656 milion dollarë gjatë një periudhe 18 mujore.

Kësti i parë prej 18,760 milion dollarë është paguar menjëherë pasi është miratuar kërkesa ndërsa këstet tjera parashihen të paguheshin pas vlerësimeve që do të bëhen çdo tre muaj. Në këto vlerësime shihet nëse Qeveria e Kosovës u është përmbajtur kushteve nën të cilat ka marrë këtë asistencë nga FMN-ja. Ç'është edhe më e rëndësishme, me përmbajtjen këtyre kushteve janë të lidhura edhe asistencat që vijnë nga Banka Botërore dhe Komisioni Evropian. Kështu, përmbushja e kushteve nga kjo kontratë është esenciale që Kosova të marrë rreth gjithsej 300 milionë

Euro nga FMN-ja, BB-ja dhe Komisioni Evropian.

Në arsyetimin në kërkesën që i ka bërë FMN-së për Stand-by Arrangement Qeveria e Kosovës ka thënë se cak i programit ekonomit të qeverisë është shtrirja e bazamentit për rivendosjen e qëndrueshmërisë fiskale dhe të ruajtjes së stabilitetit financiar. Për të arritur këtë, autoritetet synojnë që, ndër të tjera, të "ushtrojnë kufizime në shpenzime dhe të shtojnë të ardhurat" për të përballuar barrën që investimet kapitale do të kenë në deficitin e përgjithshëm fiskal.

Rritja e pagave nga Qeveria e Kosovës që është bërë në fillim të janarit 2011 nuk duket të jetë në përputhje me kufizimin e shpenzimeve që për të cilin është zotuar Qeveria në kontratën me FMN-në dhe me këtë rrezikon jo vetëm marrëveshjen me FMN-në dhe fondin prej 90 milion dollarëve, por edhe milionat e tjerë nga Banka Botërore dhe Komisioni Evropian.

Vlerësimi nga FMN-ja është dashur të bëhet në muajin dhjetor por kjo nuk është bërë pasi vendi nuk ka pasur një qeveri⁵ dhe është shtyrë për kohën kur të emërohet qeveria e re. Për këtë shkak nuk ka ende një vlerësim zyrtar nga FMN-ja për vendimin e Qeverisë së Kosovës për të rritur pagat dhe i mbetet qeverisë që të arsyetojë këtë vendim para delegacionit të FMN-së dhe të mos e prishë kontratën me këtë institucion.

4 Dokumentacioni i plotë gjendet në faqen: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2010/cr10245.pdf>

5 Qeveria e tashme është në largim dhe nuk njihet si partner për të negociuar me FMN-në.

OSE QEVERI TË KORRUPTUAR
OSE INVESTIME TË HUAJA

Dita e mirë shihet në mëngjes

Kosova nuk e ka filluar mbarë ndërtimin e shtetit dhe me këtë rrezikon të ardhmen e vet dhe të qytetarëve të saj. Porosia që Kosova deri tani u ka dërguar investitorëve potencialë është se shteti i ri nuk është një vend në të cilin ja vlen të investohet dhe në të cilin nuk mund të bësh biznes pa u lidhur me politikën dhe krimin. Autoritetet e Kosovës duhet ta marrin në konsideratë këtë dhe të punojnë të ndryshojnë këtë imazh të Kosovës. E mënyra më e mirë për të ndryshuar imazhin e Kosovës është duke e ndryshuar gjendjen në terren dhe realitetin në Kosovë.

Mesazhet e deritashme nga Kosova nuk kanë qenë inkurajuese për qytetarin e Kosovës. Largimi i kompanive më të mëdha të globit, si në rastin e licencës për telefoni-në e dytë mobile i dërgon mesazh negativ edhe kompanive tjera se Kosova nuk është vend ku mund të investohet.

Edhe dështimi për ta respektuar kontratën e parë me FMN-në do t'i kushtonte shumë shtrenjtë Kosovës, jo vetëm për shkak se do të humbë fondet, por edhe për shkak se tërë botës do t'i thuhej qartë që Kosova nuk i respekton kontratat, bile as ato që i nënshkruan me miqtë e saj.

TË BËRIT BIZNES

119	TË BËRIT BIZNES 2011 RADHITJA		
118	TË BËRIT BIZNES 2010 RADHITJA		
-1	NDRYSHIMI NË RADHITJE		
RAJONI	Evropa Lindore & Azia Qendrore		
KATEGORIA E TË ARDHURAVE	Të ardhura mesatare të ulëta		
POPULLSIA	1,805,000		
TË HYRAT KOM- BËTARE BRUTO PËR KOKË BANORI (US\$)	3,240.00		
RRADHITJA	BB2010	BB2011	NDRY- SHIMI
Fillimi i biznesit	163	158	-5
Procedurat rreth lejes së ndërtimit	173	177	4
Regjistrimi pronësi	65	64	-1
Marrje të huas	32	30	-2
Mbrojtje të investitorit	173	172	-1
Pagesën e tatimit	41	51	10
Tregtim përtej kufjeve	130	131	1
Zbatimin e kontratës	155	155	
Mbylljen e biznesit	31	28	-3

Lehtësia e të bërit biznes

NE KOSOVE Kjo faqe paraqet një përmbledhje të të dhënave mbi Të Bërit Biznes në Kosovë për vitin 2011. Tabela e parë tregon renditjen e përgjithshme dhe sipas temave (nga 183 ekonomitë), bazuar në "Lehtësia e të bërit biznes". Tabelat tjera përmbledhin treguesit kryesor për çdo temë dhe standardet, në krahasim me mesataret e ekonomive rajonale dhe atyre me të ardhura të larta (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)

FILLIMI I BIZNESIT

163	RADHITJA BB 2011
156	RADHITJA BB 2010
-5	NDRYSHIMI NË RADHITJE

TREGUESIT	KOSOVE	EVROPA LINDORE & AZIA QENDRORE	ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE ZHVILLIM
NUMRI I PROCEDURAVE	10	6.3	5.6
KOHA E NEVOJSHME (DITË)	58	16.3	13.8
KOSTOJA*	28.7	8.5	5.3
PAGESA MINIMALE E KAPITALIT*	112.4	12.3	15.3

*% E TË ARDHURAVE PËR KOKË BANORI

NUMER	PROCEDURA	KOHA E NEVOJSHME	SHPENZIMET
1	Hapja e llogarisë bankare dhe depozitimi i kapitalit	1 ditë	EUR 5
2	Kërkesa dhe marrja e Certifikatës Biznesore dhe e "Informacionit të biznesit" nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit e Kosovës (ARBK)	10 ditë	Pa pagesë
3	Pagesa e tarifës për regjistrimin e biznesit në bankë	1 ditë	EUR 23.5
4	Mbarimi i vulës së kompanisë	1 ditë	EUR 20-50
5	Kërkesa dhe marrja e lejes nga komuna	30 ditë	Pa pagesë
*6	Kërkesa dhe zbatimi i inspektimit nga Komiteti Teknik i Komunës	5 ditë (të përfshira në procedurën paraprake)	EUR 525 për leje, EUR 50 për inspektim
7	Kërkesa dhe marrja e numrit fiskal nga Administrata Tatimore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	7 ditë	Pa pagesë
*8	Inspektimi i lejes për biznes nga Administrata Tatimore	1 ditë, njëkohësisht me procedurën 7	Pa pagesë
9	Regjistrimi i kompanisë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave	7 ditë	Pa pagesë
10	Regjistrimi i të punësuarve për planin pensional në Administratën Tatimore, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	1 ditë	Pa pagesë

*NJËKOHËSISHT ME NJË PROCEDURË TJETËR.

Përmbledhje e shtypit ndërkombëtar përëndimor lidhur me Raportin e Dick Marty, dhjetor 2010, janar-shkurt 2011

► International Herald Tribune – The Global Edition of New York Times

http://www.nytimes.com/2011/02/04/world/europe/04iht-organ04.html?_r=1&scp=1&sq=Dick%20Marty&st=cse

<http://www.nytimes.com/2011/01/27/world/europe/27iht-kosovo27.html?scp=3&sq=Dick%20Marty&st=cse>

<http://www.nytimes.com/2010/12/19/world/europe/19kosovo.html?scp=8&sq=Dick%20Marty&st=cse>

<http://www.nytimes.com/2010/12/16/world/europe/16kosovo.html?scp=4&sq=Dick%20Marty&st=cse>

► Foreign Policy

http://blog.foreignpolicy.com/posts/2010/12/21/kosovo_pm_vows_to_fight_organ_trafficking_allegations

http://blog.foreignpolicy.com/posts/2010/12/14/kosovo_pm_accused_of_running_organ_and_weapons_smuggling_ring

► The Washington Post

<http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2011/01/28/AR2011012804673.html>

<http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2011/01/07/AR2011010703160.html>

► The Financial Times

<http://www.ft.com/cms/s/0/9cd5c6f4-2a52-11e0-b906-00144feab49a.html#axzz1CzK2fUn7>

<http://www.ft.com/cms/s/0/423881be-28a4-11e0-aa18-00144feab49a.html#axzz1CzK2fUn7>

<http://www.ft.com/cms/s/0/f4ec439c-093f-11e0-ada6-00144feabdc0.html#axzz1CzK2fUn7>

► The Times

<http://www.thetimes.co.uk/tto/public/sitesearch.do?querystring=Dick+Marty&p=tto&pf=all&bl=on>

► The Independent

<http://blogs.independent.co.uk/2010/12/23/the-human-organs-of-the-council-of-europe-evidence-please/>

<http://www.independent.co.uk/news/world/europe/kosovos-pm-linked-to-trade-in-human-organs-2160629.html>

► The Guardian

<http://www.guardian.co.uk/world/2011/jan/24/hashim-thaci-kosovo-organised-crime?INTCMP=SRCH>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/23/albania-war-crimes-organ-theft-claim?INTCMP=SRCH>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/21/kosovo-hashim-thaci-inquiry?INTCMP=SRCH>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/18/kosovo-to-decide-its-future?INTCMP=SRCH>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/17/kosovo-medicus-organ-clinic>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/17/kosovo-pm-denies-mafia-claims>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/17/kosovo-organ-donor-ring-israel>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/17/endorsement-kosovo-organ-trade>

<http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2010/dec/15/balkans-report-blairs-liberal-intervention>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/15/kosovo-crime-ring-examine-hashim-thaci>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/14/illegal-organ-removals-charges-kosovo>

<http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/14/kosovo-prime-minister-like-mafia-boss>

► The Economist

http://www.economist.com/node/18013840?story_id=18013840

http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2011/01/kosovo_and_albania

http://www.economist.com/node/17733187?story_id=17733187

► Der Spiegel

<http://www.spiegel.de/spiegel/print/d-75803491.html>

<http://www.spiegel.de/spiegel/print/d-75803499.html>

<http://www.spiegel.de/politik/ausland/0,1518,734741,00.html>

<http://www.spiegel.de/politik/ausland/0,1518,728827,00.html>

► Neue Zuercher Zeitung

<http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/>

[kosovos_gefahrlichster_mann_mit_schweizer_vergangenheit_1.9248788.html](http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/kosovo_organhandel_dick_marty_sonderermittler_aus_1.9245976.html)

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/kosovo_organhandel_dick_marty_sonderermittler_aus_1.9245976.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/breite_zustimmung_zu_martys_kosovo-bericht_1.9223684.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/eu-mission_verlangt_von_marty_beweise_1.8887274.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/nato-dokumente_belasten_thaci_schwer_1.9211053.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/kosovo_organhandel_marty_1.9215247.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/organhandel_marty_kosovo_1.9219925.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/demonstration_gegen_dick_marty_angekuendigt_1.9185128.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/dick_marty_geht_in_kosovo_berichten_ueber_organhandel_nach_1.4555776.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/neue_anschuldigungen_im_kosovo-organhandelskandal_1.9013310.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/kosovov_hashim_thaci_interview_marty_1.8938573.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/eu-mission_verlangt_von_marty_beweise_1.8887274.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/demonstration_gegen_dick_marty_angekuendigt_1.9185128.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/kosovo-regierungschef_als_mafiaboss_und_organhaendler_thaci_marty_1.8687388.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/kultur/aktuell/marty_und_die_maertyrer_1.9167370.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/eu-mission_verlangt_von_marty_beweise_1.8887274.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/schwere_vorwurfe_keine_schuldsprueche_1.8729337.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/thacis_zweite_front_1.8729372.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/realpolitik_im_27_kanton_1.8729336.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/schweiz_eda_calmy_rey_kosovo_preis_verzicht_1.8725614.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/dick_marty_verteidigt_seinen_kosovo-bericht_1.8713157.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/dick_marty_interjurassische_versammlung_1.8721639.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/startseite/opfer_und_

[taeter_1.8712976.html](http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/thaci_klagt_gegen_marty_1.8706547.html)

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/thaci_klagt_gegen_marty_1.8706547.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/die_vergangenheit_holt_thaci_ein_1.8696736.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/schauerliches_ueber_kosovos_regierungsspitze_1.8696716.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/del_ponte_kosovo_organhandel_1.8709935.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/marty_bekraeftigt_mafiavorwurfe_gegen_thaci_1.8708131.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/schweiz/martys_methode_1.8707494.html

http://www.nzz.ch/nachrichten/politik/international/kosovo-regierungschef_als_mafiaboss_und_organhaendler_thaci_marty_1.8687388.html

► Le Monde

http://www.lemonde.fr/idees/article/2010/12/28/la-rumeur-de-burrel_1458015_3232.html

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/26/trafic-d-organes-belgrade-accuse-l-ONU-de-dissimulation-de-preuves_1457927_3214.html

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/21/trafic-d-organes-pristina-pour-l-ouverture-d-une-enquete_1456372_3214.html

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/20/la-serbie-souhaite-une-enquete-sur-les-trafics-d-organes-au-kosovo_1455783_3214.html

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/17/kosovo-les-faiblesses-du-rapport-sur-les-trafics-d-organes_1454470_3214.html

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/16/selon-la-justice-serbe-le-trafic-d-organes-a-concerne-500-victimes-dans-les-annees-90_1454535_3214.html

http://www.lemonde.fr/cgi-bin/ACHATS/acheter.cgi?offre=ARCHIVES&type_item=ART_ARCH_30J&objet_id=1143247

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/15/le-kosovo-dement-l-implication-dans-un-trafic-d-organes-l-europe-s-inquiete_1454028_3214.html

http://www.lemonde.fr/europe/article/2010/12/15/le-conseil-de-l-europe-accuse-l-uck-de-trafic-d-organes_1453524_3214.html

► Corriere della Sera

http://www.corriere.it/cronache/10_dicembre_15/traffico-corpi-kosovo-cina_047c6608-0827-11e0-b759-00144f02aabc.shtml

OSE QEVERI TË KORRUPTUAR OSE INVESTIME TË HUAJA

OSE QEVERI TË KORRUPTUAR OSE INVESTIME TË HUAJA

Klubi për Politikë të Jashtme është organizatë joqeveritare e cila mbledh rreth vetës intelektual, politikan dhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile, që tregojnë afinitet në politikë të jashtme. Klubi ka për qëllim që përmes një debati intelektual të kontribuojë përmes rekomandimeve në gjenerimin e politikave të jashtme të Kosovës, në funksion të paqes në Kosovë, rajon dhe botë. Klubi gjeneron debate, i analizon zhvillimet dhe jep rekomandime për politikën e jashtme të Kosovës; përqendrohet në analizimin e trendeve globale të cilat kanë ndikim në përditshmërinë politiko-ekonomike në Kosovë si dhe në hulumtimin e mundësive që i ofrohen Kosovës në një botë në integrim. Klubi do të përpiqet që të sjell në vëmendje debatet aktuale botërore në opinionin kosovar dhe të tërheqë vëmendjen për hapat e domosdoshëm të politikës kosovare karshi këtyre zhvillimeve.

Klubi përmes aktiviteteve të tij dhe një debati intensiv do të gjenerojë rekomandime dhe programe lidhur me proceset integruese rajonale, evropiane dhe globale, në veçanti në procesin e integritetit në BE dhe NATO, të cilat i vihen në dispozicion institucioneve të Kosovës. Fokus i veçantë i organizatës do të jetë zhvillimi i një debati mbi veprimet imediate që Institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmarrin në rrafshin diplomatik në funksion të njohjes së Kosovës nga shtetet anëtare të OKB-së, si dhe pranimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, siç është OKB-ja, KE-ja, OSBE-ja, Banka Botërore, IMF, Organizata e Konferencës Islamike, Komiteti Olimpik etj. Klubi do të ketë për synim që të nxis një debat të tillë përderisa nuk arrihet njohja e Kosovës nga shumica e vendeve botërore dhe pranimi i saj si anëtare e organizatave të lartpërmendura.

BORDI KLUBIT:

Veton Surroi (Kryetar),
Venera Hajrullahu, Leonora Kryeziu,
Valon Murati, Xhabir Hamiti dhe
Ylli Hoxha (Drejtor Ekzekutiv).

KËSHILLI PROGRAMOR I KLUBIT:

Vlora Çitaku, Bujar Bukoshi, Ardian Gjini, Sadik Idriz, Ibrahim Gashi, Mimoza Kusari, Naser Rugova, Lulezim Peci, Luan Sllaku, Ilir Dugolli, Haki Abazi, Fatmir Aliu, Arjeta Emra, Antigona Baxhaku, Gëzim Salihu, Erolld Belegu, Fatmir Gashi dhe Agim Zogaj.

STAFI I KLUBIT:

Ylli Hoxha, Venhar Nushi,
Rrahim Sejdiu, Besa Luci, Driton Sylja,
Ardian Arifaj, Hajrulla Çeku,
Arban Mehmeti, Valentina Shyti,
Kushtrim Dumoshi.



**Klubi për
Politikë të
Jashtme**